

Thirrja për aplikim të studentëve në programin certifikues të Qendrës për Energji dhe Qëndrueshmëri të Universitetit të Prishtinës

Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri e Universitetit të Prishtinës (QEQ) ju fton të bashkoheni në programin më aktual dhe më inovativ ndërdisiplinorë në Universitetin e Prishtinës – programi certifikues i QEQ:

Menaxhimi i Energjisë dhe i Mjedisit

Studio disa nga sfidat më aktuale në botë – ndryshimet klimatike, qëndrueshmërinë energjetike, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e energjisë në komunitet dhe më shumë – me profesorë kryesorë nga Universiteti i Prishtinës dhe nga jashtë. Programet do të ofrojnë kurse të fokusuar nga shumë Fakultete. Të diplomuarit e programeve do të marrin certifikatë universitare krahas diplomës së tyre bachelor apo master.

Të drejtë aplikimi kanë studentët nga të gjitha Fakultetet e Universitetit të Prishtinës të cilët kanë të regjistruar së paku semestrin e dytë të studimeve bachelor si dhe të gjithë studentët e tjerë.

Për të marrë certifikatën e veçantë universitare ***Menaxhimi i Energjisë dhe i Mjedisit*** studentët duhet të përfundojnë me sukses katër kurse nga lista e kurseve ndërdisiplinore të ofruara në QEQ, përkatësisht të fitojnë 20 kredi ECTS. Çdo kurs do të ofrojë pesë kredi ECTS të cilat do të llogariten si shtesë e kredive të fituara në kuadër të programeve përkatëse të diplomimit të studentit.

Kurset që do të ofrohen këtë semestër në kuadër të programit ***Menaxhimi i Energjisë dhe i Mjedisit*** janë: Parimet e Menaxhimit të Energjisë (O), Esenca e Gjurmëve për Zhvillim të Qëndrueshëm (Z), Bazat e Qëndrueshmërisë Mjedisore (Z), Proceset e Gjellbëra për Qëndrueshmëri (Z) dhe Ekoklimatologjia dhe Biomasa (Z).

Tarifa e regjistrimit për programin certifikues është **25 Euro**.

Studentët e interesuar për programet certifikuese mund t’i marrin të gjitha informatat në web-faqen e QEQ: <https://qeq.uni-pr.edu/>

Aplikimet e kompletuara dorëzohen në zyrën e QEQ (Administrata Qëndrore) deri më **14 Mars 2025**.

Procedura e aplikimit realizohet përmes: <https://studenti.uni-pr.edu/>